

# Banka e Shqipërisë



## Rezultatet e Vrojtimit të Biznesit dhe të Konsumatorit

**Nëntor 2009**


Publikimi i ardhshëm i rezultateve të vrojtimeve të besimit do të bëhet në 15 shkurt 2010.

### Tendenca ekonomike

Treguesi i tendencës ekonomike\* (TTE) u rrit me 3.6 pikë në tremujorin e tretë të vitit 2009, krahasuar me tremujorin e mëparshëm, duke regjistruar vlerën 88.5. Kjo përbën rritjen e dytë të njëpasnjëshme tremujore të treguesit, i cili shënoi vlerën e tij më të ulët historike në tremujorin e parë të këtij viti. Niveli aktual i TTE qëndron 11.5 pikë më poshtë se mesatarja e tij afatgjatë.

Përmirësimi në treguesin e tendencës është shkaktuar nga kombinimi i lëvizjeve me kahe të ndryshme të balancave përbërëse. Rritja e besimit në sektorin e industrisë dhe të ndërtimit ka kompensuar rënien në besimin e konsumatorëve, duke dhënë një kontribut neto pozitiv në TTE gjatë tremujorit të tretë. Besimi në sektorin e shërbimit ka dhënë një kontribut të papërfillshëm në TTE. Gjithsesi, nivelet e treguesve të besimit për të tre sektorët e ekonomisë qëndrojnë poshtë mesatares së tyre afatgjatë.

Grafik 1: Treguesi i Tendencës Ekonomike.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.


\* Shpjegimet metodologjike mbi mënyrën e ndërtimit të treguesit të tendencës ekonomike (TTE), të treguesve të besimit (TB) dhe të treguesit të balancës mund të gjenden në aneks ose në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë në adresën:

[http://www.bankofalbania.org/web/pub/metodologjia\\_vbb\\_vbk\\_shqip\\_2301\\_1.pdf](http://www.bankofalbania.org/web/pub/metodologjia_vbb_vbk_shqip_2301_1.pdf)

## Sektori i industrisë

Në tremujorin e tretë të vitit 2009, treguesi i besimit të industrisë (TBI) është rritur me 6.2 pikë përqindjeje, krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Ndryshimi i TBI në tremujorin e parë dhe të dytë të këtij viti është përkatësisht -14.4 dhe +2.2 pikë përqindje. Niveli i TBI qëndron poshtë mesatares së tij afatgjatë me një diferencë prej 8.3 pikësh përqindje. Vlerësimi i bizneseve për *prodhimin industrial*, balanca e të cilit u rrit me 11.7 pikë përqindjeje, dha kontributin kryesor në rritjen e treguesit të përgjithshëm të industrisë. Balanca e vlerësimeve të bizneseve të industrisë për situatën e *punësimit*, megjithëse mbetet në nivele negative, shënoi një kthesë drejt rritjes pas prires së theksuar rënëse që nga tremujori i katërt i vitit 2008. *Inventarët* vlerësohen me një rënie të lehtë në këtë tremujor, duke dhënë një kontribut të vogël por pozitiv në rritjen e TBI.

Grafik 2: Treguesi i Besimit të Industrisë.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

### Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBI:

Bizneset e industrisë kanë shfrytëzuar kapacitetet e tyre prodhuese në tremujorin e tretë të vitit 2009 me një normë më të lartë se në tremujorin e dytë të vitit (norma u rrit në 68 për qind nga 66 për qind). Vlerësimi i tyre për *ecurinë e ekonomisë* në përgjithësi dhe për *aktivitetin e përgjithshëm të biznesit* të tyre ka shënuar rritje, megjithëse balancat\* e përgjigjeve për këto pyetje mbeten në nivele negative. Bizneset kanë vlerësuar në një shkallë më të ulët rëndësie pothuaj të gjithë faktorët që pengojnë aktivitetin e tyre të biznesit.

Në tremujorin e tretë të vitit 2009, bizneset raportuan një rritje të lehtë të *kërkesës së brendshme* dhe një përmirësim të nivelit të *kontratave porositëse*, megjithëse balanca e këtyre të fundit mbetet negative. Balanca e *kërkesës së jashtme* për eksporte është vlerësuar në rritje për të dytin tremujor radhazi, pas rënies së theksuar në tremujorin e parë të këtij viti. Megjithatë, ajo mbetet në nivele negative. *Çmimet e prodhimit* industrial janë vlerësuar në rritje gjatë tremujorit aktual.

Vlerësimet e bizneseve për *investimet* e kryera gjatë periudhës prill-shtator 2009 kanë shënuar një rënie nga vrojtimi në gjashtëmujorin e kaluar: 76.5 për qind e bizneseve nuk kanë kryer investime të reja. 89 për qind e bizneseve që kanë kryer investime i kanë përqendruar ato në pajisje teknologjike të reja dhe 11 për qind në struktura të reja.


*Pritjet* e bizneseve të sektorit të industrisë për *ecurinë e aktivitetit* të tyre gjatë tremujorit të katërt të këtij viti, si dhe për *ecurinë e ekonomisë* në përgjithësi janë në rritje. Ndërkohë, bizneset nuk presin ndryshime në nivelin e *prodhimit* industrial, *kërkesën* dhe gjendjen e *punësimit*.

\* Shih Aneksin.

## Sektori i ndërtimit

Treguesi i besimit të ndërtimit (TBN) është rritur me 3.4 pikë përqindjeje në tremujorin e tretë të vitit 2009, krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Përmirësimi i treguesit të agreguar në këtë sektor është shkaktuar nga zhvillime kryesisht pozitive në komponentët përbërës të tij. Kontributin më të madh në përmirësimin e treguesit të besimit të ndërtimit e ka dhënë rritja e balancës së *prodhimit*, e cila u rrit me 9.5 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e mëparshëm. *Kërkesa* në ndërtim është vlerësuar më pak negativisht në tremujorin aktual, balanca u rrit me 1.2 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e dytë të vitit. Situata e *punësimit* është vlerësuar negativisht në tremujorin e tretë të vitit, duke shënuar një rënie të lehtë prej 0.6 pikë përqindjeje krahasuar me një tremujor më parë. Edhe pse treguesi i besimit të ndërtimit shënoi zhvillime pozitive gjatë tremujorit të tretë të vitit, vlera e tij ndodhet nën mesataren afatgjatë.

Grafik 3: Treguesi i Besimit të Ndërtimit.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

### Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBN:

Vlerësimi i bizneseve të ndërtimit për *ecurinë e ekonomisë* në përgjithësi, megjithëse në përmirësim të ndjeshëm nga vrojtimi i kaluar, mbetet në nivele negative edhe për tremujorin e tretë të vitit (balanca -14.4 për qind nga -22.9 për qind që ishte në tremujorin e dytë të vitit). Shfrytëzimi i kapaciteteve ndërtuese, në tremujorin e tretë të vitit 2009, u rrit në 68.9 për qind, rreth 2.2 pikë përqindjeje më i lartë krahasuar me tremujorin e dytë të vitit. Prania e korrupsionit dhe ekonomisë informale, si dhe marrëdhëniet me bankat vlerësohen të jenë ndër faktorët kryesorë të cilët kanë ndikuar negativisht aktivitetin e tyre.

*Inventarët* kanë shënuar një rënie të lehtë në tremujorin e tretë të vitit. Bizneset raportojnë për një rritje të ndjeshme të *çmimeve të prodhimit* gjatë tremujorit të tretë të vitit (balanca u rrit me 10.5 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e dytë të vitit), *gjendja financiare* e bizneseve raportohet më e keqësuar se në tremujorin e kaluar, balanca ra në -3.1 për qind nga -2.2 për qind që ishte në tremujorin e mëparshëm.


Në gjashtëmujorin prill – shtator 2009, niveli i investimeve në sektorin e ndërtimit pësoi rënie, balanca u ul me 2.1 pikë përqindjeje krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm. Investimet e kryera nga bizneset e këtij sektori konsistuan kryesisht në pajisje teknologjike.

Për tremujorin e katërt të vitit 2009 bizneset presin një përmirësim të përgjithshëm të aktivitetit ekonomik dhe të prodhimit të tyre, ndërsa *pritjet* për investime të reja në gjashtëmujorin e ardhshëm janë negative.

## Sektori i shërbimeve

Treguesi i besimit të shërbimeve (TBSH) ka regjistruar një rritje të lehtë me 0.6 pikë përqindjeje në tremujorin e tretë të vitit 2009, duke qëndruar aktualisht 4.7 pikë përqindjeje më poshtë mesatares së tij afatgjatë. Bizneset kanë rritur vlerësimin për *ecurinë e ekonomisë* dhe situatën e *punësimit* në sektorin e tyre, balancat janë rritur përkatësisht me 5.6 dhe 3 pikë përqindjeje në krahasim me tremujorin e dytë të vitit. Përmirësimi i tyre është kundërbalancuar nga vlerësimi negativ i gjendjes së tyre financiare (balanca ra me 6.7 pikë përqindjeje).

Grafik 4: Treguesi i Besimit të Shërbimeve.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

### Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBSH:

Pavarësisht vlerësimit të rritur për *ecurinë e ekonomisë* në përgjithësi, bizneset e shërbimeve kanë vlerësuar në rënie aktivitetin e biznesit të tyre gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009. Bizneset kanë vlerësuar në një shkallë më të lartë situatën e ekonomisë informale dhe kërkesën si faktorët që kanë penguar aktivitetin normal të shërbimeve gjatë tremujorit aktual.

Kërkesa për shërbime është vlerësuar në rënie në tremujorin e tretë të vitit 2009. Kapacitetet janë shfrytëzuar në masën 76 për qind, në krahasim me 80 për qind të tremujorit të tretë të vitit 2008.

Çmimet e prodhimit janë vlerësuar në rritje, për të dytin tremujor me radhë. Megjithatë, gjendja financiare e tyre nuk regjistron përmirësim.


Për sa i përket investimeve gjatë gjashtëmujorit të fundit, 69 për qind e bizneseve janë shprehur se nuk kanë kryer investime të reja.

*Pritjet* e firmave të sektorit të shërbimit për tremujorin e katërt të vitit 2009 flasin për një përmirësim të lehtë të situatës në këtë sektor.

## Besimi i Konsumatorit

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009, treguesi i besimit të konsumatorit (TBK) pësoi një rënie të lehtë me rreth 1.8 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e dytë të vitit. Treguesi i besimit konsumator, edhe pse në nivele negative, ndodhet rreth 2.2 pikë përqindjeje mbi mesataren e tij afatgjatë. Zhvillimet negative në treguesin e agreguar u shkaktuan nga kombinimi i zhvillimeve me kahe të ndryshme në katër komponentët përbërës të tij. Më konkretisht, balancat e pritjeve të konsumatorëve mbi *situatën e përgjithshme ekonomike* dhe mbi *situatën e tyre financiare* për tremujorin e katërt të vitit, kontribuan negativisht në TBK. Në të njëjtin drejtim ndikoi edhe balanca e *blerjeve në shumën të mëdha*, e cila shënoi rënie me 1.5 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Zhvillime pozitive vihen re në balancën e situatës së *kursimit*, ku edhe pse në nivele negative, balanca u rrit me 4.5 pikë përqindjeje.

Grafik 5: Treguesi i Besimit të Konsumatorit.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBK:

*Situata financiare aktuale* e konsumatorëve gjatë tremujorit të tretë u vlerësua negativisht, balanca shënoi rënie me 9.9 pikë përqindjeje krahasuar me një tremujor më parë. Nga ana tjetër, vlerësimi për situatën e përgjithshme ekonomike në vend është përmirësuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009.

Bazuar në pritjet sasiore të konsumatorëve për inflacionin *pas 12 muajsh*, vlera e pritur rezultoi +2.0 për qind, rreth 0.3 pikë përqindjeje më e lartë se ajo e tremujorit të kaluar. Gjithashtu, balancat e *pritjeve* (cilësore) të konsumatorëve për çmimet pas një tremujori dhe pas një viti shënuan vlera pozitive. Për sa i përket nivelit të papunësisë në gjashtëmujorin e ardhshëm, rreth 45.4 për qind e konsumatorëve presin që ai të rritet (krahasuar me 35.9 për qind në vërtetimin e kaluar) dhe rreth 15.4 për qind e tyre presin që ai të ulet (krahasuar me 27.7 për qind në vërtetimin e kaluar).

Tabelë 1: Treguesit e besimit sipas sektorëve\*.

	Vlerat që nga T2-2002			2008		2009			Situata	
	min.	mes.	max.	T3	T4	T1	T2	T3	Konjunkturale**	Strukturore***
Industri	-18.2	-1.5	6.0	0.2	-3.7	-18.2	-15.9	-9.8	↑	--
Ndërtim	-16.5	-1.9	8.9	-0.6	1.5	-16.5	-11.6	-8.2	↑	--
Shërbime	-15.9	1.6	17.9	17.9	10.6	-5.6	-3.7	-3.2	↑	-
Konsumator	-20.5	-13.1	-7.8	-10.5	-17.4	-17.3	-8.8	-10.5	↓	-

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

\*) Me përjashtim të treguesit të konsumatorit, treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara sezonalisht.

\*\*) Situata krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

\*\*\*) Situata për secilin tregues konsiderohet shumë e kënaqshme (+ +) kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; situata konsiderohet e kënaqshme (+) kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; situata konsiderohet e pakënaqshme (-) kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe situata konsiderohet shumë e pakënaqshme (-) kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.







Tabelë 2: Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë\*.

	2008				2009			Pritje
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4
<b>Kërkesa</b>								
Total	6.0	4.1	7.6	5.4	-11.0	-4.6	-8.0	6.9
Industri	3.7	1.2	-2.5	-5.9	-29.9	-25.5	-16.7	3.4
Ndërtim	6.2	11.2	0.6	6.9	-23.1	-10.6	-9.4	1.6
Shërbime	6.7	1.6	13.9	8.1	0.4	4.6	-4.6	10.4
<b>Situata ekonomike e firmës</b>								
Total	9.0	6.2	10.3	5.6	-12.0	-3.5	-6.8	8.1
Industri	-1.6	1.2	-5.5	-6.3	-28.3	-27.9	-15.1	4.2
Ndërtim	6.4	7.0	-9.7	-2.4	-15.0	-4.1	-2.0	3.1
Shërbime	13.1	7.3	24.5	13.0	-5.7	4.2	-6.5	11.6
<b>Prodhimi</b>								
Total	11.8	5.0	-2.2	-1.2	-18.9	-18.6	-8.2	4.7
Industri	5.3	0.3	-5.4	-6.5	-27.6	-24.6	-12.9	0.7
Ndërtim	16.0	8.0	-0.1	2.2	-13.4	-14.7	-5.2	7.2
<b>Konsumatorët</b>								
Situata financiare	-13.5	-9.7	-3.8	-9.9	-15.0	5.5	-4.4	2.2
Çmimet pas 1 viti	25.2	21.1	23.0	17.3	9.5	-0.3	17.8	
Blerje të mëdha	-50.9	-45.8	-43.7	-52.7	-50.5	-42.3	-43.8	-32.9
Kursim	-53.2	-50.3	-50.6	-54.4	-52.2	-50.6	-47.4	-42.9

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.


\*) Me përjashtim të sektorit të konsumatorëve, balancat janë të rregulluara sezonalisht.

**Grafik 6: Balancat kryesore të agreguara në nivel ekonomie.**



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

**Grafik 7: Balancat kryesore të konsumatorëve.**



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

## **Aneks**

### **Shpjegime metodologjike.**

-**Balanca** është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vërtetimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

-**Treguesi i Besimit (TB)** ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht, të treguesve të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

-**Treguesi i Tendencës Ekonomike (TTE)** përmbledh të gjitha balancat (13) e përdorura për llogaritjen e treguesve të besimit për të katër sektorët, të peshuara sipas aktivitetit ekonomik. Ai shpreh me anë të një treguesi të vetëm ndjesitë për aktivitetin ekonomik në vend, të dy prej grupeve kryesore ekonomike: bizneset dhe konsumatorët.